



KURTI: ASOCIACIONI MUND TË ADRESOHET NË MARRËVESHJEN FINALE



Pas deklaratës së këshilltarit të lartë të Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, se Asociacioni i Komunave me

Shumicë Serbe është çështje urgjente, ka reaguar kryeministri Albin Kurti, duke theksuar se çështja e themelimit të këtij asociacioni

mund të adresohet brenda një marrëveshje eventuale për normalizimin e plotë të raporteve midis Kosovës dhe Serbisë

CHOLLET NË BEOGRAD BËN THIRRJE PËR DIALOG PËR PROPOZIMIN FRANKO-GJERMAN



150 TË RINJ DO TA KENË MUNDËSINË TË TRAJNOHEN PËR PROGRAMIN E AFTËSIVE DIGJITALE | FAQE 7


AKTUALE



IBRAHIMI: SJELLJET E ESTABLISHMENTIT POLITIK NË KOSOVË VAZHDOJNË TË JENË FËMIJËRORE | F. 5

DALLIMET MIDIS TRUMPIT DHE BIDENIT LIDHUR ME DOKUMENTET E KLASIFIKUARA | F. 5

I JEPET LAMTUMIRA E FUNDIT PROFESORIT DHE ISH-LUFTËTARIT TË UÇK-SË, SABHAJDIN CENA | F. 6



EKONOMI



HOTI: INFLACIONI 12 PËR QIND, MASAT ASKUND, QYTETARËT BARTIN PASOJAT | F. 8

ODA E HOTELERISË DHE E TURIZMIT MBËSHTET FUSHATËN 'MOS BLI PRODHIME SERBE' | F. 8

SPORT



TREPÇA - PRISHTINA, NDESHJA KRYESORE E JAVËS SË 18 NË SUPERLIGË | F.11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Maqedonia e Veriut merr drejtimin e OSBE-së

SHKUP, 13 JANAR - Ministri i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, ka paraqitur në Vjenë programin e punës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, drejtimin e së cilës e mori nga 1 janari. Osmani ka theksuar prioritetet e organizatës, duke nënvizuar Ukrainën në krye të listës, ndërsa tha se agresioni rus, shkatërrimet dhe vdekjet e civilëve, duhet të ndalen. Kryesuesi i ri i OSBE-së, ministri i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani foli për një agjendë ambicioze të presidencës maqedonase në rrethana komplekse për shumë pjesë të globit, ndërsa tha se uniteti rreth

parimeve dhe angazhimeve të OSBE-së paraqet burim shprese dhe inkurajimi.

Ai tha se Ukraina mbetet çështja më me prioritet për OSBE-në. "Agresioni duhet të ndalet. Vdekja e civilëve dhe shkatërrimi janë të papranueshme. Është e dhimbshme t'i shikosh vuajtjet e njerëzve. Pasojat dhe çmimi i kësaj lufte janë të papërbalueshme dhe të padurueshme për rajonin e OSBE-së dhe përtej", ka deklaruar Osmani.

Ai nënvizoi rrezikun e krizave të tjera, duke thënë se paqëndrueshmëria rajonale dhe mundësia për një konflikt të ri duhet ta kenë vëmendjen e

vazhdueshme të OSBE-së. Kryediplomati i Maqedonisë së Veriut tha se duhet të ruhen funksionimi thelbësor dhe veprimet e organizatës për t'u siguruar se ajo do t'i mbështesë rajonet e rrezikuara dhe të jetë e gatshme për t'iu përgjigjur sfidave.

Në Vjenë ministri Osmani pati edhe takime dypalëshe me homologë të tij prej disa vendeve evropiane.

Maqedonia e Veriut do të ketë drejtimin e OSBE-së deri më 31 dhjetor.

Autoritetet në Shkup shpresojnë se kryesimi i kësaj organizate të madhe ndërkombëtare do të ketë ndikim pozitiv për vetë pozitën e



vendit në shumë fusha, përfshirë zhvillimin ekonomik dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme.

OSBE-ja numëron 57 vende anëtare nga Evropa, Amerika e Veriut dhe Azia.

Suedia: Protesta kundër Erdoganit, akt sabotimi ndaj anëtarësimit në NATO

STOKHOLM, 13 JANAR - Kryeministri i Suedisë, Ulf Kristersson, ka dënuar protestën e organizuar nga kurdët në qendër të Stokholmit, ku një manekin, që i ngjasonte presidentit turk, u var në një shtyllë. Ai e quajti këtë veprim si akt të sabotimit kundër aplikimit të Suedisë për anëtarësim në NATO.

Protesta e organizuar të mërkurën para ndërtesës së komunës së qytetit nxitte reagime të ashpra nga Turqia, shtet anëtar i NATO-s, që veçse po bllokoi anëtarësimin e Suedisë në aleancë deri kur Stokholmi t'i plotësojë kërkesat e paraqitura nga Ankaraja.

Kryetari i Parlamentit të Turqisë, Mustafa Sentop, anuloi vizitën e homologut të tij suedez Andreas Norlen, që ishte paraparë të zhvillohej të hënën. Ligjvënësit



turq duhet ta rafitikojnë aplikimin e Suedisë për anëtarësim në NATO në mënyrë që ky shtet nordik të bëhet pjesë e aleancës ushtarake

perëndimore. Turqia i ka vendosur kushte Stokholmit në këmbim të ratifikimit të anëtarësimit të Suedisë në NATO. Ankaraja ka

kërkuar që Stokholmi t'i shtypë militantët kurdë dhe grupet e tjera që Turqia i konsideron si kërcënim për sigurinë e saj kombëtare.

Ministria e Jashtme e Turqisë thirri në bisedë ambasadorin suedez të enjten lidhur me protestën në Stokholm.

Kristersson tha se varja e manekinit që i ngjasonte presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ishte një veprim "shumë serioz" që "tallej me ekzekutimin e një lideri të huaj, të zgjedhur në mënyrë demokratike". "Ky është sabotim kundër aplikimit të Suedisë në NATO. Një veprim i tillë është i rrezikshëm për sigurinë suedeze". Në mediet sociale janë postuar fotografi të një manekini që i ngjasonte Erdoganit. Manekini ishte varur kokëposhtë.

Grupi që e quan veten Komiteti i Solidaritetit suedez për Rojava tha se qëndron pas protestës.

Rojava është emër kurd për Sirinë veriore dhe lindore.

Ministri i Jashtëm i Turqisë, Mevlut Cavusoglu, tha se Partia e Punëtorëve të Kurdistanit dhe grupet kurde "po vendosin mina në rrugën e Suedisë drejt NATO-s". Pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës, Suedia dhe Finlanda vendosën të aplikojnë për anëtarësim në NATO. Të 30 anëtarët e aleancës duhet të pajtohen në mënyrë që këto dy shtete të bëhen pjesë e NATO-s.

Turqia ka kërkuar nga Finlanda dhe Suedia që të veprojnë më shumë kundër grupeve që ajo i konsideron terroriste dhe t'i ekstradojë në Turqi personat që i kërkon për krime të lidhura me terrorizmin.

NATO-ja do t'i zhvendosë avionët e zbulimit në Rumani

BRUKSEL, 13 JANAR - NATO po zhvendos disa prej avionëve të saj të zbulimit në Rumani të cilët aktualisht gjenden në Gjermani. Këta avionë do të jenë më afër territorit të Ukrainës teksa Rusia po vazhdon pushtimin e këtij shteti.

Avionët e zbulimit me Sistemin Ajror të Paralajmërimit dhe Kontrollit (AWACS) pritet të arrijnë në Bukuresht të martën "për ta mbështetur praninë e përforcuar të aleancës në rajon dhe për ta monitoruar aktivitetin ushtarak rus", ka theksuar NATO përmes një njoftimi.

Avionët AWACS, që zakonisht janë të stacionuar në perëndim të Gjermanisë, do të stacionohen në bazën e forcave ajrore



rumune në Otopeni afër Bukureshtit, rreth 200 kilometra nga kufiri me Ukrainën. Këta avionë do të qëndrojnë në Rumani – shtet anëtar i NATO-s

dhe Bashkimit Evropian për disa javë. "Teksa lufta e paligjshme e Ruisë në Ukrainë vazhdon ta kërcënojë paqen dhe sigurinë në Evropë, nuk duhet të ketë

dyshime lidhur me vendosmërinë e NATO-s për të mbrojtur çdo centimetër të territorit të aleatëve", ka pohuar zëdhënësja e NATO-s, Oana

Lungescu, duke shtuar se AWACS-ët tanë mund t'i zbulojnë avionët nga qindra kilometra largësi, duke i bërë ata një aftësi kyçe për parandalimin dhe qëndrimin e mbrojtjes të NATO-s. "E falënderojmë Rumaninë që do t'i pranojë avionët, shtet i cili jep një kontribut të rëndësishëm për paralajmërimin tonë të hershëm", ka theksuar ajo.

Rreth 180 pjesëtarë të personelit ushtarak, po ashtu, do të dislokohen në bazën në Otopeni. NATO nuk ka specifikuar se sa prej 14 avionëve të saj AWACS, që aktualisht gjenden në Gjermani, do të dërgohen në Rumani. Por, sipas burimeve, Dpa ka mësuar se tre avionë do të dërgohen në Rumani.

Chollet në Beograd bën thirrje për dialog për propozimin franko-gjerman

PRISHTINË, 13 JANAR - Këshilltari special i Departamentit Amerikan të Shtetit, Derek Chollet, në një takim me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se Beogradi dhe Prishtina duhet të fokusohen në diskutimet për propozimin franko-gjerman për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi si dhe për formimin e shpejtë të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Kështu ka bërë me dije zyra e presidentit të Serbisë pas bisedës së tyre në Beograd më 12 janar. "Këshilltari special Chollet theksoi se Shtetet e Bashkuara do

t'i mbështesin gjithmonë të gjitha përpjekjet e bëra për ta ruajtur paqen dhe stabilitetin, duke theksuar se (ShBA-ja) mbron vendosjen e fokusit të agjendës drejt së cilës palët në dialog duhet të fokusohen në bisedimet për planin franko-gjerman si dhe për formimin e shpejtë të Asociacionit", thuhet në njoftim. Më herët, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha se pret që ShBA-ja ta inkurajojë Kosovën që "t'i përmbushë obligimet e saj në përputhje me marrëveshjet e nënshkuara". "Shpreha pritjen që ShBA-ja t'i njohë përpjekjet e vendit tonë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon, si dhe ta

përdorë ndikimin e saj të padyshimtë dhe ta inkurajojë Prishtinën që t'i përmbushë obligimet e saj në përputhje me marrëveshjet e nënshkuara, por edhe ta vazhdojë dialogun në frymën e shkëmbimit të sinqertë dhe të hapur të propozimeve për zgjidhjen e sfidave specifike", ka shkruar Vuçiq në "Instagram" më 12 janar pasi postoi një fotografi të përbashkët me Cholletin.

Ai shtoi se ka pasur një "bisedë përmbajtësore dhe të hapur" me këshilltarin e Departamentit Amerikan të Shtetit.

Derek Chollet mbërriti në Beograd nga Prishtina më 12 janar.

Një nga temat e diskutimit edhe në

takimet me zyrtarët e Serbisë ishte vazhdimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke përfshirë edhe planin evropian për Kosovën. Ai plan iu dorëzua autoriteteve në Prishtinë dhe Beograd në fund të verës dhe mbështetet nga Franca, Gjermania dhe ShBA-ja.

Në tekstin e planit thuhet se palët janë të vetëdijshme se pacenueshmëria e kufijve dhe integritetit territorial dhe sovranitetit dhe mbrojtja e pakicave kombëtare janë kushtet themelore për paqen.

Ai, gjithashtu, parasheh njohjen e simboleve shtetërore dhe një marrëveshje të veçantë për

komunitetin serb në Kosovë.

Siç është bërë me dije, Chollet me zyrtarët në Beograd ka diskutuar edhe për sigurinë energjetike, integrimin ekonomik rajonal, përparimin e Serbisë në rrugën evropiane dhe rolin e saj në forcimin e paqes dhe sigurisë rajonale.

Derek Chollet gjatë një bisede që bëri me gazetarët në Prishtinë më 11 dhjetor tha se "Kosova duhet t'i përmbushë të gjitha zotimet në kuadër të dialogut, përfshirë edhe formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe" dhe se presin nga "Qeveria e Kosovës të vendosë disa propozime në tryezë".



Nehammer: Austria e gatshme të dërgojë trupa shtesë në Kosovë



VJEN, 13 JANAR - Kancelari i Austrisë, Karl Nehammer, ka thënë se shteti i tij është i gatshëm të dërgojë trupa shtesë në Kosovë në kuadër të misionit të NATO-s, KFOR, nëse një gjë e tillë i kërkohet zyrtarisht nga aleanca ushtarake perëndimore.

Gjatë një konference të përbashkët për medie në Vjenë me kryeministrin e Kosovës, Albin

Kurti, Nehammer ka theksuar se shteti i tij ka numrin më të madh të trupave në KFOR nga shtetet që nuk janë pjesë e NATO-s, duke shtuar se përkrahin idenë e Kosovës për trupa shtesë. "Ne e mbështesim thirrjen e Kosovës për rritje të trupave për siguri më të madhe dhe do të jemi të gatshëm të ofrojmë trupa mbështetëse nëse KFOR-i na e kërkon këtë gjë, sepse

është me rëndësi të dihet që edhe komunitetet e ndryshme pajtohen me praninë e KFOR-it. Pra, jemi plotësisht të bindur dhe të gatshëm të ofrojmë më shumë trupa nëse kjo kërkohet zyrtarisht nga NATO-ja, nga KFOR-i", ka thënë ai.

Aktualisht në Kosovë janë 232 trupa austriake në kuadër të KFOR-it.

Tahiri: BE-ja le ta kushtëzojë Serbinë

PRISHTINË, 13 JANAR - Ish-kryenegociatorja e Kosovës me Serbinë, Edita Tahiri, ka thënë se Bashkimi Evropian (BE) duhet ta kushtëzojë Serbinë, duke ia bërë të qartë se do ta ndalë

integrimin e saj në BE nëse nuk vendos sanksione kundër Rusisë. "Zyrtari i lartë amerikan, Chollet, kërkoi dje nga Serbia të vendosë sanksione kundër Rusisë. Tash duhet edhe BE-ja ta

kushtëzojë Serbinë, duke ia bërë të qartë se do ta ndalë integrimin e Serbisë në BE nëse nuk vendos sanksione kundër Rusisë. Këto dy politika të qarta amerikane dhe evropiane do t'i

hapin rrugë marrëveshjes finale me njohje reciproke! Pa u shkëputur nga Rusia, Serbia do të mbetet problemi i Ballkanit!", ka shkruar Tahiri në "Facebook".





Kurti: Asociacioni mund të adresohet në marrëveshjen finale

Pas deklaratës së këshilltarit të lartë të Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe është çështje urgjente, ka reaguuar kryeministri Albin Kurti, duke theksuar se çështja e themelimit të këtij asociacioni mund të adresohet brenda një marrëveshje eventuale për normalizimin e plotë të raporteve midis Kosovës dhe Serbisë

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se çështja e themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe mund të adresohet brenda një marrëveshje eventuale për normalizimin e plotë të raporteve midis Kosovës dhe Serbisë. Këto komente të Kurtit, të bëra gjatë vizitës në Austri, vijnë një ditë pasi zyrtari i lartë amerikan, Derek Chollet, ka thënë se Asociacioni është një çështje urgjente dhe ka kërkuar nga Kosova të japë propozime sa i përket themelimit të Asociacionit. Këshilltari i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, gjatë një vizite në

Prishtinë, ka thënë se Kosova “duhet t’i përmbushë të gjitha zotimet në kuadër të dialogut, përfshirë edhe formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe”. “Asociacioni është një çështje urgjente në agjendën e dialogut. Ka marrë një rëndësi edhe më të madhe pas ngjarjeve të fundit në veri”, ka thënë Chollet. Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se një asociacion njëetnik është kundër frymës së Kushtetutës të Kosovës. “Jemi në një moment kur flasim dhe diskutojmë për një marrëveshje të normalizimit të plotë të raporteve mes Kosovës dhe Serbisë dhe aty edhe çështja e Asociacionit mund të adresohet. Megjithatë, Kushtetuta e Kosovës, që i ka dhënë shumë privilegje

pakicës serbe dhe që është përpiluar nga zoti [Marty] Ahtisaari dhe nga zoti Albert Rohan, në frymën e saj nuk lejon asociacion njëetnik. Fjalja e parë e atij plani, e asaj zgjidhjeje që është hartuar nga Ahtisari dhe Rohan, thotë se Kosova duhet të jetë një shoqëri shumetnike”, ka deklaruar Kurti, duke iu referuar të ashtuquajturit Planit i Ahtisaarit, që i parapriu shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 2008. “Do të thotë, asociacionet apo institucionet monoetnike nuk janë në frymën e atij plani apo Kushtetutës sonë. Megjithatë, ne ofrojmë garanci dhe të drejtat më të mira dhe më të mëdha për të gjitha pakicat ose komunitetet joshumicë në Kosovë dhe jam shumë i angazhuar në këtë drejtim. Por, pa nënvlerësuar kushtetutshmërisë e vendit tonë”, ka thënë Kurti. Kosova dhe Serbia, në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, kanë arritur dy marrëveshje sa i përket Asociacionit, përkatësisht më 2013 dhe 2015. Gjykata Kushtetuese e Kosovës më 2015 tha se marrëveshja e

nënshkruar po atë vit për themelimin e Asociacionit binte ndesh në disa pika të aktit më të lartë të shtetit. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian vazhdimisht i kanë kërkuar Kosovës që ta respektojë këtë marrëveshje dhe ta themelojë Asociacionin. Madje ShBA-ja ka paralajmëruar se nëse Qeveria e Kosovës nuk e formon, atëherë do të kërkohen “partnerë alternativë” për formimin e Asociacionit. Serbia insiston në formimin e Asociacionit, ndërkaj Kurti ka shprehur shqetësimin e tij se një Asociacion, me kompetenca ekzekutive - ashtu siç e kërkon Serbia - do të nënkuptonte “bosnjezim” të Kosovës. Por, i dërguari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se Asociacioni as nuk duhet të jetë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe të krijojë “shtet brenda shtetit”. Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog me ndërmjetësimin e BE-së që nga viti 2011. Prishtina kërkon që një marrëveshje finale me Serbinë ta përfshijë njohjen

reciproke, ndërkaj Beogradi dëshiron një zgjidhje kompromisi, pa treguar se për çfarë kompromisi bëhet fjalë. Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe parashikohet që të mbledhë rreth vetes dhjetë komuna në Kosovë të banuara me shumicë serbe: Mitrovicë e Veriut, Kllokot, Partesh, Ranillug, Graçanicë, Zveçan, Zubin Potok, Novobërdë, Leposaviq dhe Shtërpçë. Sipas marrëveshjeve, Asociacioni ka për qëllim t’i përfaqësojë interesat kolektive të këtyre komunave, veçmas në fushën e arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural si dhe të ekonomisë. Marrëveshja e vitit 2013 për Asociacionin thekson se ai do të krijohet me statut dhe strukturat e tij, mbi bazën e statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Po ashtu, thuhet se Asociacioni do të ushtrojë edhe përgjegjësi të tjera shtesë, varësisht se si delegohen nga autoritetet qendrore dhe që do të ketë një rol përfaqësimi tek autoritetet qendrore.

Dallimet midis Trumpit dhe Bidenit lidhur me dokumentet e klasifikuara

UASHINGTON, 13 JANAR - Prokurori i Përgjithshëm Merrick Garland ka emëruar dy këshilltarë të posaçëm për të kryer hetime të pavarura lidhur me mënyrën se si ish-presidenti republikan Donald Trump dhe pasardhësi i tij demokrat, Joe Biden, kanë vepruar lidhur me të dhënat e klasifikuara.

Jack Smith, prokuror për krime të luftës, po heton nëse Trumpi dhe bashkëpunëtorët e tij mbanin në mënyrë jo të duhur dokumentet e klasifikuara në pronën private të Trumpit në Florida, pasi ai përfundoi mandatin si president më 2021. Smith, po ashtu, po heton nëse Trumpi ka tentuar ta pengojë hetimin federal. Garland ka emëruar Robert Hur nga Marilend për ta hetuar posedimin e të dhënave të klasifikuara nga koha kur Bideni ishte nënpresident, pasi disa prej tyre u gjetën në shtëpinë e tij dhe në zyrën e Qendrës Penn Biden.

Cilat janë ngjashmëritë e këtyre dy rasteve?

As Trump, e as Biden nuk do të duhej të kishin në posedim materiale të klasifikuara. Gjatë periudhës së tranzicionit të mandatit presidencial, të dhënat e çdo administrate duhet të dorëzohen tek Arkivat Kombëtare të Shteteve të Bashkuara.

Është e paligjshme që me qëllim dhe vullnet të merren në posedim materialet e klasifikuara. Dështimi për t'i ruajtur këto materiale të klasifikuara siç duhet, paraqet rrezik për sigurinë kombëtare, nëse ato bien në duar të gabuara. Biden ka deklaruar se ishte i befusuar kur mësoi se ai kishte pasur në posedim informacione të klasifikuara. Trump ka thënë në mediet sociale, pa ofruar dëshmi, se ai i kishte deklasifikuar dokumentet, edhe pse avokatët e tij kanë refuzuar që të përfshijnë këtë pohim në dosjet gjyqësore.

Dokumentet për të cilat bëhet fjalë datojnë nga koha kur Biden



ishte nënpresident në administratën e Barack Obamës, përkatësisht në periudhën 2009-2017, dhe kur Trump ishte president nga viti 2017 deri më 2021.

Si dallojnë këto dy raste?

Ekspertët ligjorë kanë deklaruar se ka dallime të mëdha në këto dy raste.

Në rastin e Trumpit, Arkivat Kombëtare për më shumë se një vit pasi Trump përfundoi mandatin, tentuan të merrnin të gjitha të dhënat që ish-presidenti kishte në pronësi, por pa sukses. Kur më në fund Trump dorëzoi 15 paketa me dokumente në janar të vitit 2022, zyrtarët e Arkivave zbuluan se ato përmbanin materiale të klasifikuara.

Çështja u dërgua te Departamenti i Drejtësisë, që lëshoi një urdhër në maj, me synim që të merreshin të gjitha të

dhënat e klasifikuara. Hetuesit më pas vizituan shtëpinë e Trumpit, ku avokatët e tij dorëzuan më shumë materiale dhe deklaruan se nuk ka më dokumente në këtë pronë.

Por, këto pretendime dolën të jenë të rreme. Të dhëna të reja u mbledhën nga Byroja Federale e Hetimeve (FBI), përfshirë edhe pamje nga kamerat në pronën në Mar-a-Lago, duke shtyrë agjentët që të kërkonin miratim nga gjykata për të mundësuar që të kryenin kontroll më 8 gusht, pas shqetësimeve se mund të ketë pengesë të mundshme ligjore.

FBI-ja mori edhe 13.000 dokumente shtesë dhe rreth 100 prej tyre ishin të shënuara se ishin dokumente të klasifikuara.

Në rastin e Bidenit, Garland tha se avokatët e presidentit informuan Arkivat dhe Departamentin e Drejtësisë në nëntor, duke u thënë se kishin gjetur më herët gjatë atij muaji disa dokumente të klasifikuara në Qendrën Penn

Biden në Uashington.

Pas këtij zbulimi, avokatët vazhduan të bënin kontrolle shtesë në shtëpinë e Bidenit në Uillington dhe Rehoboth Biç në Dellauer, ku u gjetën më shumë dokumente në dhjetor dhe gjatë këtij muaji. Të gjitha këto materiale janë dorëzuar tek autoritetet.

Me çfarë rreziqesh ligjore përballen Biden dhe Trump?

Në SHBA, konsiderohet krim vetëm nëse dokumentet e klasifikuara merren dhe mbahen me qëllim.

Prokurorët zakonisht nuk ngrenë aktakuzë nëse dokumentet e klasifikuara merren nën posedim aksidentalisht, por nëse ka të dhëna se ka pasur pengim të drejtësisë, gjërat mund të ndryshojnë.

Për këtë arsye, ekspertët ligjorë

thanë se Trump përballlet me më shumë rreziqe ligjore sesa Biden. Deri më tani, nuk ka pasur asnjë sugjerim nga Departamenti amerikan i Drejtësisë se Biden me vetëdije kishte marrë nën pronësi materialet apo kishte refuzuar që t'i kthente ato te Qeveria.

Po ashtu, si president, Biden ka pak të ngjarë që të ndiqet penalisht. Departamenti amerikan i Drejtësisë nuk ka ndryshuar politikën e saj që thotë se presidenti në detyrë nuk mund të akuzohet.

E njëjta politikë ndihmoi që Trump të mbrohej kur ishte president dhe po hetohej nga këshilltari i posaçëm, Robert Mueller. Në atë rast, Mueller refuzoi të përcaktonte nëse Trump kishte penguar hetimin e tij për lidhjet e mundshme midis Rusisë dhe fushatës presidenciale të vitit 2016 të Trumpit, pikërisht për shkak të politikës shumëvjeçare të Departamentit të Drejtësisë.

Ibrahimi: Sjelljet e establishmentit politik në Kosovë vazhdojnë të jenë fëmijërore



PRISHTINË, 13 JANAR - Analisti politik Ilir Ibrahimi ka thënë se sjelljet e establishmentit politik në vendin tonë, sidomos në 7-8 vjetët e fundit, fatkeqësisht vazhdojnë të jenë fëmijërore. "Nëse lexohet me kujdes editoriali i Bloombergut, i botuar edhe në 'Washington Post', mund ta vërejmë se si e sheh establishmenti i Washingtonit sot Kosovën, që do të duhej të ishte një shenjë alarmi për klasën politike por edhe shoqërinë kosovare. Kosova

nuk shihet më si një fëmijë i vogël, të cilit ndonjëherë edhe mund t'i falen lazdrimllëqet, por si një vend, relacioni me të cilin varet ekskluzivisht nga sjelljet dhe qëndrimet e tij. E sjelljet e establishmentit politik kosovar, sidomos në 7-8 vitet e fundit, fatkeqësisht vazhdojnë të jenë fëmijërore", ka shkruar Ibrahimi në "Facebook".

Ai ka theksuar se klasa politike, por edhe shoqëria e Kosovës, duhet ta mësojnë një herë e mirë se partneriteti me

ShBA-në nuk duhet të merret si i mirëqenë, por ai duhet të meritohet. "Kosova duhet të tregohet partner serioz, e denjë për këtë partneritet sepse ai është vital. Mundësia më e mirë për të treguar kesi lloj partneriteti është konstruktiviteti në dialog dhe arritja e një marrëveshjeje me Serbinë sa ma parë sepse kjo përveç se është interes i rëndësishëm për vendin, është edhe interes strategjik amerikan", ka theksuar Ibrahimi.

I jepet lamtumira e fundit profesorit dhe ish-luftëtarit të UÇK-së, Sabahajdin Cena

RAHOVEC, 13 JANAR - Në varrezat e qytetit të Rahovecit i është dhënë lamtumira e fundit profesorit dhe ish-luftëtarit të UÇK-së, Sabahajdin Cena. Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se Cena vdiq pas një sëmundje të rëndë. "Sabahajdin Cena i bëri jehonë luftës së lavdishme të popullit shqiptar me emblemën e UÇK-së në krye. Prof. dr. Sabahajdin Cena u bë një me luftën çlirimtare duke u bërë kronisti i kësaj historie të lavdishme në trojet shqiptare e më gjerë. Emri i tij do të gdhendet me shkronja ari, ndërsa kronikat e tij për UÇK-në do të vazhdojnë të bëjnë jehonë në histori. Lavdi e nderim për njeriun e pushkës e të penës, profesor dr. Sabahajdin Cena! Ngushëllime familjes së ngushtë, fafesisit, bashkëlufetarëve dhe të gjithë atyre që ndiejnë dhembje për humbjen e prof. dr. Sabahajdin Cena!", ka thënë Latifi. Sabahajdin Cena së fundi ishte këshilltar për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së në zyrën e kryetarit të Rahovecit, Smajl

Latifi. Ngushëllime familjes Cena i kanë shprehur edhe përfaqësues të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së. "Paska ikur në amshim profesor Sabahajdin Cena, njeriu i pushkës e penës. Ngushëllime familjes, bashkëlufetarëve, shokëve e miqve! Lavdi jetës dhe veprës së tij!", ka shkruar në "Facebook" ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku. Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se me pikëllim të thellë ka marrë lajmin për vdekjen e intelektualit dhe atdhetarit të madh Sabahajdin Cenës. "Ai ishte zëri intelektual dhe çlirimtar i Kosovës në ditët më të vështira. Me vargjet e poetëve shqiptarë u jepte zemër ushtarëve të UÇK-së, të etur për lirinë e vendit. Trimëria dhe vendosmëria e tij deri në vetëmohim, do të kujtohet gjithmonë në historinë tonë kombëtare. Ngushëllimet më të sinqerta familjes Cena, bashkëlufetarëve dhe gjithë qytetarëve të Rahovecit!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



Çerdhja e fëmijëve "Gëzimi Ynë" në Mitrovicë bëhet me infrastrukturë moderne

MITROVICË, 13 JANAR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, së bashku me nënkryetarin Arian Tahiri dhe drejtoreshën e Arsimit, Drita Kadriu, ishin pjesë e ceremonisë solemne me rastin e përfundimit të investimeve të kryera në çerdhjen publike "Gëzimi Ynë". Me këtë rast, kryetari i komunës, Hamza, ka thënë se ky është një ndër investimet më të qëlluara të realizuara deri më tani sepse i dedikohet zhvillimit të hershëm të fëmijëve, të cilët padyshim se janë perspektiva dhe e ardhmja e vendit tonë. Ai më tutje ka shtuar se fëmijët e çerdhës "Gëzimi Ynë" do të kenë




kushte moderne për rritjen dhe edukimin e tyre, nën kujdesin cilësor të edukatoreve të mrekullueshme, ndërsa investimet në këtë çerdhje do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2023,

ku do të bëhet edhe rregullimi i oborrit, hapësirave rekreative dhe këndit të lojërave për fëmijë. Ky investim i komunës së Mitrovicës në bashkëpunim me FKEE kap shumë më 400 mijë euro.

Rruga "Xhorxh Bush" hapet vetëm për autobus, taksi dhe automjetet emergjente

PRISHTINË, 13 JANAR - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se pas përfundimit të intervenimeve në infrastrukturën rrugore dhe pas vendosjes së shenjzimeve, nga dita e premte rruga "Xhorxh Bush" është hapur për linjat e Trafiku Urban Prishtinë, taksitë dhe veturat emergjente (policia, zjarrfikësit, autoambulancat), të cilët do të kenë qasje në këtë shesh me shpejtësi të kufizuar të qarkullimit prej 20km/h. Kjo rrugë ka qenë e mbyllur për disa javë pas organizimit të "Tregut të fundvitit".



Komuna e Podujevës ka hapur thirrjen për subvencionimin e bizneseve prodhuese

PODUJEVË, 13 JANAR - Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit në Podujevë ka hapur thirrjen për subvencionimin e investimeve në kapacitetet prodhuese. Vlera financiare e mbështetjes do të jetë 200 000 euro. Komuna e Podujevës do të

subvencionojë 30 për qind të vlerës së investimit në kapacitetet prodhuese (maksimumi 10 000 euro për një përfitues). Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë deri më 10 shkurt. "Siç jemi zotuar para qytetarëve dhe

bizneseve në fushatën zgjedhore se do të promovojmë dhe mbështesim bizneset prodhuese në rritjen dhe zgjerimin e kapaciteteve të tyre prodhuese, ashtu edhe po veprojmë", ka thënë kryetari i Podujevës, Shpejtim Bulliqi.



150 të rinj do ta kenë mundësinë të trajnohen për programin e aftësive digjitale

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 JANAR - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë dhe Ambasada e Italisë në Kosovë kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për t'i mbështetur të rinjtë nga të gjitha komunitetet etnike për ta përmirësuar nivelin e punësueshmërisë përmes një sërë trajnimesh të përshtatura për aftësim digjital.

Për ta adresuar mungesën e aftësive digjitale në tregun e punës bazuar në komentet e ofruara nga një sërë biznesesh kosovare, më shumë se 150 të rinjve në Kosovë do t'u sigurohet qasje në një kombinim të trajnimeve të certifikuar dhe për ndërtim karriere gjatë 12 muajve të ardhshëm.

Paketat e trajnimit përfshijnë aplikacionin mobil, zhvillimin e uebit, inxhinierinë e të dhënave, rrjetëzimin, marketingun digjital dhe dizajnin digjital.

Disa trajnime do të kenë fokus të

veçantë në nevojat e industrisë së turizmit me qëllim rritjen e konkurrencës dhe produktivitetit. Me ngritjen e nivelit të digjitalizimit në ekonomi, Kosova ka një potencial të fuqishëm për ta përsheptuar rritjen e udhëhequr nga sektori privat, duke përfshirë sektorin e turizmit dhe për t'i shfrytëzuar mundësitë brenda rajonit, Evropës dhe më gjerë.

Përsheptimi i transformimit digjital kërkon, megjithatë, një sërë aftësish më të larmishme, të specializuara dhe më të shkathëta. Gjatë lansimit ambasadori italian Antonello De Riu theksoi: "Iniciativa të tilla janë vendimtare për dialogun më se të nevojshëm ndëretnik dhe promovimin e mundësive të punës për brezat e rinj. Projekti në fjalë ka edhe avantazhin e fokusimit në një fushë specifike, kapacitetet digjitale, për të cilat ka një kërkesë të konsiderueshme, përfshirë edhe nga sipërmarrjet italiane. Krejt në fund, por jo për nga rëndësia, programi është në përputhje me një iniciativë të



fundit të ndihmës (Natur Kosovo) e nisur nga Agjencia jonë për Zhvillim (AICS) dhe e fokusuar në turizëm të qëndrueshëm".

Maria Suokko, përfaqësuese e Përhershme e UNDP-së, theksoi se digjitalizimi paraqet mundësi të paprecedentë për përsheptimin e zhvillimit të qëndrueshëm. "Kjo është duke ndryshuar në mënyrë

progresive mënyrën si ne punojmë, si u qasemi shërbimeve dhe ndërveprojmë me njëri-tjetrin. Mbështetja e të rinjve, të të gjitha komuniteteve, për të fituar shkathtësi të buta dhe teknike që kërkohen në tregun aktual është me rëndësi vendimtare për ta mundësuar tranzicionin e dyfishitë në Kosovë, atë digjital dhe

të gjelbër, ku sektori i turizmit ka potencial të madh", ka deklaruar Suokko.

Programi i Aftësive Digjitale financohet nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar me 200 000 euro dhe UNDP me 100 000 euro dhe do të zbatohet gjatë 12 muajve të ardhshëm.



PDK-ja mbledh deputetët, Krasniqi: Gjithmonë do të jemi aktivë

PRISHTINË, 13 JANAR - Para fillimit të sesionit pranveror të Kuvendit, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, së bashku me deputetët e grupit parlamentar të kësaj partie, diskutuan për agjendën e tyre legjislativë dhe iniciativat konkrete të cilat do të ndërmarrin gjatë këtij viti. "PDK-ja do të jetë gjithmonë aktive, e përgjegjshme dhe konstruktive kur në pyetje janë interesat e

qytetarëve dhe shtetit të Kosovës", ka theksuar Krasniqi.

Ai ka thënë se gjatë vitit 2022, Grupi Parlamentar i PDK-së ka përmbyshur rolin e vet si lider i opozitës, me më së shumti iniciativa e projektligje të propozuara në Kuvendin e Kosovës. "Dinamika e punës do të shtohet edhe më shumë në vitin 2023", ka deklaruar Krasniqi.

Kryetari i Skenderajt pret në takim Bardhyl Mahmutin me bashkëpunëtorë

SKENDERAJ, 13 JANAR - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka pritur në takim kryetarin e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", Bardhyl Mahmutin me bashkëpunëtorë.

Nura ka thënë se ishte kënaqësi ta mirëpresë në këtë takim Bardhyl Mahmutin me bashkëpunëtorë, një patriot i vërtetë i historisë së para dhe pas

luftës. "Kënaqësi të mirëpres Bardhyl Mahmutin me bashkëpunëtorë, një patriot i vërtetë i historisë së para dhe pas luftës, pjesëmarrës i demonstratave shqiptare për Kosovën, i dënuar si shokët e tjerë, pjesë e ish-Drejtorisë Politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me një veprimtari të bujshme atdhetare", ka shkruar Nura në "Facebook".



AAK-ja ndryshon formën e kandidaturave për deputetë

PRISHTINË, 13 JANAR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka mbledhur kryesinë e partisë, me të cilën ka diskutuar për zhvillimet politike në vend. Haradinaj e ka informuar kryesinë e AAK-së rreth përmbytjes së takimit të djeshëm me delegacionin nga Departamenti i Shtetit, i

kryesuar nga Derek Chollet, këshilltar i lartë dhe Gabriel Escobar, ndihmësasistent i sekretarit të Shtetit për Çështje të Evropës dhe Euroazisë.

Po ashtu, ai ka bërë me dije se kanë diskutuar rreth planit vjetor dhe angazhimet e AAK-së më 2023. "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka

vendosur aplikimin e modelit të primareve në parti. Kjo nënkupton që kandidaturat për deputetë të dalin nga primaret, që është një model i votimeve të brendshme për kandidatura për zgjedhje të përgjithshme si dhe kandidaturave për kryetarë komunash", ka thënë Haradinaj.



Hoti: Inflacioni 12 për qind, masat askund, qytetarët bartin pasojat

“Epoka e re”

PRISHTINË, 13 JANAR - Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se inflacioni mesatar në dhjetor 2022 arriti në 12 për qind, por për disa mallra dhe shërbime elementare, ku shpenzohet shumica e buxhetit familjar, arriti në 47 për qind për shpenzime të transportit; 39 për qind për lëndë djegëse; 31 për qind për vajra dhe yndyra; 28 për qind për qumësht; djathë e vezë; 21 për qind për bukë e drithëra; 20 për qind për mish; 18 për qind për sheqer etj”, ka shkruar Hoti në “Facebook”.

Deputeti i LDK-së ka shtruar edhe një pyetje: Çfarë bënë vendet e tjera për ta ulur barrën për qytetarë? “Disa i rritën pagat për normën e inflacionit, disa i ulën ngarkesat tatimore, disa i ndihmuan qytetarët pa përjashtim në përballimin e kostos së jetesës, në veçanti subvencionuan çmimin e gazit dhe naftës, çmimet e të cilave u rritën më së shumti dhe ndikuan në rritjen e të gjitha çmimeve të tjera. Ndërkaq, në Kosovë masa substanciale nuk

shihen askund, me përjashtim të shtesave në pensione dhe asistencë që janë të përkohshme. Tatimi në Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe akciza nuk u ulën, jo se nuk ishte e përbalueshme për buxhetin, por për shkak se ishte propozuar opozita (nga LDK-ja). Si rezultat i inflacionit, shteti inkasoi shumë më tepër të hyra, të cilat nuk i shpenzoi dhe, si rezultat, ato u zhvlerësuan së paku për 12 për qind”, ka deklaruar Hoti.

Por, sipas tij, pushtetarët u kujdesën për një pjesë të bizneseve. “Ato biznese që kanë kontrata me shtetin për investime kapitale. Kuvendi e miratoi ligjin diskriminues për punët publike me të cilin bizneset mund të rritin çmimin e kontratave me shtetin deri në 20 për qind për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve. Sikur të uleshin ngarkesat tatimore dhe akciza në naftë, atëherë efektet do t'i ndienin të gjithë pa përjashtim. Nuk do të kishte pasur nevojë për këtë ligj diskriminues. Nuk do të ishin mbledhur mjete pa nevojë në buxhet, të cilat po zhvlerësohen”, ka theksuar Hoti.



Oda e Hotelerisë dhe Turizmit mbështet fushatën “Mos bli prodhime serbe”



PRISHTINË, 13 JANAR - Oda e Hotelerisë dhe Turizmit e Kosovës, duke qenë përfaqësuese e subjekteve hoteliere e turistike, mbështet fushatën për bojkotimin e produkteve serbe.

OHTK-ja u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës, në veçanti anëtarëve të saj, që të bojkotojnë çdo prodhim me prejardhje nga Serbia duke i zëvendësuar ato me prodhime vendore e në mungesë të tyre me prodhime nga vendet mike. “Jemi të bindur që ky apel do të gjejë mbështetje të fortë te subjektet hoteliere dhe turistike të cilat OHTK përfaqëson ngaqë udhëheqësit e tyre janë dëshmuar nëpër vite e dekada se e duan atdheun e tyre dhe se kanë bërë sakrifica sublime për liri, duke u përballur me sfidat dhe furtunat e kohërave të kaluara që na i solli pushtuesi. Atdhedashuria sot

tregohet duke bojkotuar çdo gjë që vjen nga armiku serb”, është thënë në njoftimin e OHTK-së.

Pronari i “Meka Halal Food”, afaristi Burim Piraj, i cili është edhe ideator i fushatës “Besa-Besë” që ka për synim sensibilizimin e masës për konsumimin e prodhimeve vendore dhe bojkotimin e produkteve që vijnë nga Serbia, ka theksuar se kjo fushatë është duke marrë hov dhe është optimist se shumë shpejt do të bëhet realitet misioni i kësaj kauze. “Synimi ynë është që së paku prodhimet finale serbe të mos kenë vend në marketet e Republikës së Kosovës, Shqipërisë dhe të gjitha trojeve shqiptare”, ka thënë Piraj për “Epokën e re”, duke shtuar se ende zyrtarisht nga institucionet e vendit kjo fushatë nuk ka marrë mbështetje.

AKB-ja: Në pandemi u shuan 20 mijë biznese

PRISHTINË, 13 JANAR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka publikuar një studim hulumtues të trendit të ndërmarrësisë në periudhën 2020 - 2022, me ç'rast u publikuan edhe të dhëna se sa biznese pushuan aktivitetin ekonomik në këtë periudhë. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini,

ka thënë se rezultatet e këtij studimi kanë pasqyruar një realitet jo të mirë për bizneset dhe ekonominë e Kosovës duke pasqyruar një trend të rritjes së mbylljes së bizneseve.

Ai ka theksuar se gjatë vitit 2020, gjatë pandemisë, janë mbyllur 20 mijë biznese e kanë mbetur pa punë më shumë se 50 mijë

punëtorë.

Sipas tij, ndërmarrësit në Kosovë janë në gjendje jo të mirë dhe kjo gjendje për fat të keq po e përcjell biznesin për një kohë të gjatë duke filluar nga pandemia Covid-19, pastaj nga kriza globale, e sidomos në vitin e fundit si rezultat i luftës në Ukrainë.



Me zbehjen e fuqisë së Rosisë në Ukrainë, në horizont po shfaqet një katastrofë e dytë



Nga Lara SETRAKIAN
"CNN"

Pas pushtimit rus të Ukrainës dhe pasojave shkatërruese humanitare që solli, do të ishte e çuditshme ta lejosh Moskën të marrë rolin e paqe-bërësit. Mjerisht kjo është pikërisht ajo që ka ndodhur në një cep të botës. Në vazhden e një përlëshje të re ushtarake midis Armenisë dhe Azerbajxhanit në vitin 2020, Rusia u lejuar të ndërmytesonte një armëpushim dhe të mbante nën kontroll të dyja palët.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, të cilat dikur kishin luajtur një rol balancues në Kaukazin e Jugut, u tërhoqën nga diplomacia aktive dhe e lanë Rusinë të vepronte si ndërmytesuesja e vetme. Moska vendosi paqeruajtës në terren për të qetësuar dhe monitoruar situatën.

Por tani duket se delegimi i kësaj detyre ishte një ide e keqe. Sepse nën hijen e luftës së Ukrainës, kjo politikë po shkakton një katastrofë tjetër humanitare dhe po i komprometon rëndë interesat e Perëndimit në rajon. Në kushtet kur Rusia është dobësuar ndjeshëm për shkak të humbjeve të rënda në Ukrainë, nuk ka një arbitër efektiv midis Armenisë dhe Azerbajxhanit.

Duke përdorur pasurinë e tij të konsiderueshme të naftës dhe gazit, Azerbajxhani ka ushtruar presion për të pasur një avantazhin maksimal në terren. Për momentin, protestuesit me mbështetjen e qeverisë azere, thonë ekspertët, po bllokojnë Korridorin Lachin, ruga kryesore

që lidh rreth 120.000 armenë etnikë të Nagorno-Karabakut me botën e jashtme.

Analistët politikë azerë, thonë se protestat në Azerbajxhan janë të paligjshme nëse ato nuk kanë miratimin e qeverisë. Furnizimet me ushqime për këtë rajon janë kufizuar shumë që nga 12 dhjetori 2022, kur nisi bllokada. Dyqanet ushqimore po e racionojnë ushqimin, me pak fruta ose perime të freskëta, ndërsa ka një mungesë të madhe të furnizimeve mjekësore, deklaruan banorët në fund të dhjetorit.

Azerbajxhani thotë se bllokada është një kundërpërgjigje ndaj aktiviteteve në minierat në zonat e kontrolluara nga armenët. Por në vend se ta çojë çështjen në ndërmjetësim ndërkombëtar, ajo ka vendosur të bllokojë tranzitin në hyrje, derisa të plotësohen kushtet e tij, një shkelje kjo e ligjit ndërkombëtar dhe humanitar.

Armenët që kam takuar nga Nagorno-Karabakh janë njerëz të përzemërt, me një identitet të thellë kulturor dhe me një besim të krishterë. Edhe në ditët më të rënda të krizës, disa u përpoqën t'u ofronin familjeve të tyre një lloj atmosfere të festës së Krishtlindjes. Por më të pambrojturit po i ndjenin pasojat e bllokadës. Dr. Biayna Sukhudyan, e cila është bllokuar në Nagorno-Karabakh, na tha në fund të dhjetorit se fëmijët po shfaqnin shenja të stresit kronik, duke përfshirë kriza nervore. UNICEF ka paralajmëruar se fëmijëve u mungojnë ushqimet bazë dhe shërbimet thelbësore.

Disa prej tyre janë ndarë nga prindërit, ose kujdestarët ligjorë ndodhen në anën tjetër të rrugës së bllokuar. "Shqetësimi i madh i

njerëzve është t'i mbajnë fëmijët e tyre në të ngrohtë dhe të ushqyer"- deklaroi Sukhudyan në një bisedë telefonike. Ajo tregtoi se si njerëzit po mbijetojnë duke ndihmuar njëri-tjetrin.

"Nëse janë dy nëna dhe vetëm njëra ka qumësht për bebe, ajo do ta ndajë me gruan tjetër dhe ta ushqejë pak më shumë me gj"- thekson ajo. SHBA, BE, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dhe më shumë se një duzinë vendesh - përfshirë Kanadanë dhe Meksikën, kanë bërë thirrje që Azerbajxhani të zhbllokojë rrugën për në Nagorno-Karabakh.

Por këto thirrje kanë rënë në vesh të shurdhër. Armenët e shohin atë si një strategji të Azerbajxhanit për t'i vdekur urie ose për t'i detyruar të largohet nga enklava e diskutueshme midis 2 vendeve. Rusia nuk ka qenë në gjendje të bëjë ndonjë lëvizje të rëndësishme për ta zbutur këtë krizë.

Por nga ana tjetër ka hezitur të lejojë ndërhyrjen e vendeve perëndimore për të hequr bllokadën. Ajo preferon të jetë fuqia kryesore në terren, duke përdorur levat që zotëron për të çuar përpara interesat e saj rajonale. Një rrjet faktorësh ekonomikë dhe strategjikë e kanë lidhur Moskën me Turqinë dhe aleatën e saj, Azerbajxhanin.

Në kushte kur gjendet nën sanksionet e Perëndimit, dhe i ka tensionuar marrëdhëniet e saj me shumë partnerë ekonomikë, Moska është bërë gjithnjë e më shumë e varur nga Turqia për shmangien e tregtisë dhe sanksioneve. Turqia është bërë një lehtësuese e madhe për eksportin e naftës dhe gazit rus si dhe importin e teknologjive strategjike, shumë

prej të cilave janë të ndaluara nga Perëndimi.

Ndërsa lidhjet ruso-turke janë forcuar akoma më shumë, Rusia ka nguruar që të zbrapsë sjelljen e Azerbajxhanit. Kjo e ka lënë situatën në rënie të lirë, duke ecur drejt rezultateve më serioze dhe potencialisht vdekjeprurëse. Ashtu si në ditët e para të masakrës së Srebrenicës, paqeruajtësit ndërkombëtarë po dështojnë të veprojnë para se të humbin jetën mijëra njerëz. Po ashtu, ajo vendos një precedent të rrezikshëm për konfliktet e ardhshme, me një rën palë që asfikson një komunitet rival duke i ndërprerë furnizimet e tij, ose duke detyruar një evakuim ose pranimin e kushteve të tij të negociatave.

Michael Rubin nga think-tanku "American Enterprise Institute", që e vëzhgon rajonin nga afër, më tha se është i shqetësuar për rrezikun e spastrimit etnik, në rast se situata lihet e pakontrolluar dhe e pambikëqyruar nga fuqitë botërore. "Pyetja kryesore është se si mund të dërgojmë vëzhgues diplomatikë apo ushtarakë në Nagorno-Karabakh. Gjenocidi ndodh zakonisht në hije. Nëse jemi në gjendje të hedhim dritë në rajon, atëherë mund të parandalojmë në mënyrë proaktive pasojat më të rënda"- theksoi Rubin.

SHBA-ja nuk është e pafuqishme në raport me këtë situatë. Ajo mund të ushtrojë presion për të krijuar një linjë ajrore transporti humanitare për të ofruar furnizime për komunitetet e Nagorno-Karabakh, ose të kërkojë veprime të mëtejshme nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, i cili u takua më 20 dhjetor 2022 për të diskutuar mbi situatën. Po ashtu Amerika ka një levë të

drejtëpërdrejtë ndikimi mbi Turqinë dhe Azerbajxhanin, me të cilën mund të stabilizojë situatën, duke përdorur një sërë mjete diplomatike dhe ekonomike. "Kur administrata Trump vendosi vetëm disa sanksione ndaj Turqisë mbi çelikin për lirimimin e pastorit amerikan Andrew Brunson, kjo krijoi presion të jashtëzakonshëm mbi presidentin turk Erdogan. Pse duhet të mos e bëjmë këtë për Nagorno-Karabakh?"- tha Rubin. Rusia dhe Turqia kanë synuar ta dominojnë Kaukazin e Jugut në kurriz të fqinjëve të tyre më të vegjël. Por ai model ka rezultuar i papërshtatshëm për të mbrojtur jetën e njeriut dhe një rend paqësor të bazuar në rregulla. Në një kohë kur Perëndimi po konkurron me Rusinë për Ukrainën - e cilësuar si një luftë e demokracisë kundër autokracisë - kjo është një arenë jetike për të theksuar të njëjtin argument, dhe për të provuar se Perëndimi ka një ndikim të vërtetë në rajonin post-sovjetik.

Sa më gjatë që ta dominojnë situatën Rusia dhe Turqia, aq më e vështirë do të jetë për fuqitë perëndimore që t'i rikthejnë gjërat në ekuilibër. Pra me kalimin e kohës stabilizimi i Kaukazit Jugor do të bëhet më i kushtueshëm. SHBA-ja dhe BE-ja ia lanë në mënyrë të pamatur Rosisë ruajtjen e paqes në Kaukazin e Jugut. Tani fuqitë perëndimore duhet të ndërhyjnë me peshën e tyre të plotë diplomatike për ta korrigjuar këtë gabim.

Shënim: Lara Setrakian, gazetare dhe presidente e Institutit të Kërkimit të Politikave të Aplikuara me seli në kryeqytetin e Armenisë, Jerevan. Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Prishtina u ofron kontrata profesionale katër lojtarëve të rinj

PRISHTINË, 13 JANAR (ER) - FC Prishtina është duke vazhduar të angazhohet për ofrimin e lojtarëve të rinj dhe me potencial në ekipin

e parë. Reart Bajrami, Naxhi Berisha, Pëllumb Glloku dhe Blendrit Krasniqi janë katër futbollistët e radhës që

kanë firmosur kontrata profesionale me skuadrën nga kryeqyteti. Lojtarët e rinj janë paraqitur në ekipin e parë nga drejtori

sportiv Driton Krasniqi dhe stafi përcjellës i klubit. Ata janë shprehur të lumtur që janë pjesë e ekipit të parë të "bardhekaltërve".



Trepça - Prishtina, ndeshja kryesore e javës së 18 në Superligë

PRISHTINË, 13 JANAR - Fundjava do të sjellë ndeshje tejet interesante në Superligën e Kosovës në basketboll. Sot (e shtunë) dhe nesër (e diel) do të zhvillohen takimet e vlefshme për xhiron e 18. Vëmendja kryesore do të jetë në palestrën "Minatori", aty ku Trepça do të përballlet me Sigal Prishtinën. Kjo përballje Prishtinën e gjen në krye të tabelës, me tri pikë më shumë se mitrovicasit që janë të katërtit. Nga dy ndeshjet e luajtura në mes të tyre në këtë edicion, secila ka nga një fitore. Bardhekaltrit shkojnë në Mitrovicë pas triumfit në derbi me Pejën në mesjavë, teksa Trepça i është rikthyer fitores përballë Rahovecit në udhëtim. Kjo përballje do të luhet sot (e shtunë) nga ora 17:00.

Po në këtë ditë, por në orën 19:00, Ponte Prizreni pret Golden Eagle Yllin. Kjo është ndeshja e dytë e tyre brenda pak ditësh, pasi janë përballur edhe në mesjavë, ku suharekasit kanë fituar me rezultat të ngushtë. Që kur në

xhiron e katërt Ponte e kishte mposhtur Yllin, kjo skuadër nuk di për humbje, duke marrë 12 fitore rresht. Kjo ecuri fantastike i ka ngritur kampionët në vendin e tretë. Në anën tjetër, prizrenasit janë të parafundit në klasifikim.

Ndërsa nesër (e diel) na presin dy ndeshje të tjera. Nga ora 17:00 Peja i shkon Vëllaznimit dhe do ta kërkojë fitoren që të mbetet në garë për pozitën e parë.

Në anën tjetër, gjakovarët do të kërkojnë të dalin në vendin e pestë, duke kaluar Bashkimin, nëse eventualisht pëson humbje. Bilanci në mes të tyre është i barabartë, me pejanët që kanë fituar si mysafirë, njëjtë edhe gjakovarët.

Sfida e fundit do të jetë mes Bashkimit e Rahovecit. Prizrenasit cilësohen favoritë, duke parë formën tejet të dobët të vreshtarëve, të cilët e shohin veten në fund të tabelës. Njëra prej dy fitoreve të rahovecasve deri më tani është pikërisht ndaj portokallinjve.



Arabia nuk ndalet me Ronaldon, 300 milionë euro në vit për Messin



RIAD, 13 JANAR - Tashmë nuk është sekret që Arabia Saudite dëshiron ta rrisë turizmin dhe ta përmirësojë imazhin e saj ndërkombëtar përmes futbollit. Dëshira për ta pritur Kupën e Botës 2030, së bashku me Greqinë dhe Egjiptin, është një nga arsyet që po e shtyjnë vendin arab të nënshkruajë me ikona dhe milionerë. Pas ardhjes së Cristiano Ronaldos tek Al Nassri, sipas "Mundo Deportivo", një tjetër klub saudit, Al Hilal, është seriozisht i

interesuar për lojtarin më të rëndësishëm në botë: Leo Messi.

Klubi saudit, sipas gazetës spanjolle, është i gatshëm të bëjë gjithçka për të nënshkruar me kampionin argjentinas. Flitet për një ofertë prej 300 milionë eurosh në vit. Takimi mes palëve mund të zhvillohet së shpejti, duke qenë se është planifikuar një ndeshje miqësore mes PSG-së dhe Al Hilalit.

Negocimi me klubin parisien është padyshim larg nga të qenit

i thjeshtë por, sipas "Mundo Deportivo", ka një detaj që mund ta lehtësojë marrëveshjen: fakti që Messi është një ambasador i turizmit saudit dhe shpesh, në rrjetet sociale, ai e gjente veten duke promovuar pikat e nxehta turistike.

Sipas "The New Arab", babai dhe agjenti i numrit dhjetë të Argjentinës, Jorge Messi, ka mbërritur tashmë në Riad për të diskutuar një marrëveshje të mundshme me klubin arab për sezonin e ardhshëm.

Egzon Qerimi rikthehet te Llapi

PODUJEVË, 13 JANAR (ER) - KF Llapi ka rikthyer në radhët e veta Egzon Qerimin. Klubi nga Podujeva ka njoftuar zyrtarisht të premtën për arritjen e marrëveshjes me

mesfushorin e talentuar. "Mesfushori qendror vjen te Llapi pas një eksperience me Dukagjinin e Klinës. KF Llapi njofton se ka arritur marrëveshje me

mesfushorin qendror Egzon Qerimi. 29-vjeçari rikthehet në ekipin e vendlindjes pas disa viteve të kaluara në KEK, Onix, Arbëri, Ulpianë e së fundmi në Dukagjinin e

Klinës. Qerimi do të bashkohet sot me ekipin në përgatitje për edicionin pranveror dhe do të jetë përfundim për mesfushën e ekipit", ka njoftuar KF Llapi.





**Ndërmarrja Publike Lokale
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë**



Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A. shpall këtë:

KONKURS

Për pozitat:

I. Kontrollor/e, pesëmbëdhjetë (15)

Departamenti i Operimeve, Divizioni i Kontrollit, nr. ref.: 05/3

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kontrollimi i korrektesisë së parkimit në parkingjet rrugore dhe lëshimi i dënimeve kontraktuale;
- Pranimi nga dispeçeri i kompjuterit portativ në fillim të ndërrimit dhe lajmërohet për punë në të;
- Vizita në vendet e përcaktuara;
- Evidentimin e veturave, përkatësisht shfrytëzuesve të parkingjeve të cilët kanë bërë shkelje të dispozitave të rregulloreve të ndërmarrjes për organizimin dhe mënyrën e pagesës së parkimit;
- Në kompjuterin portativ regjistrohet të dhënat e automjetit dhe lokacionin e shkeljes;
- Lëshon urdhrin për pagesën e dënimit kontraktual, shfrytëzuesit të parkimit i/e cili/a ka bërë shkeljen e rregulloreve të ndërmarrjes;
- Pas përfundimit të ndërrimit e kthen kompjuterin portativ tek Dispeçeri.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Diploma e shkollës së mesme;
- Preferohet të ketë përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Preferohet të ketë shkathtësi kompjuterike elementare;

Procedura e Konkurrimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe certifikatën mbi të kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit.

Kontratë pune për periudhë të caktuar: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë të përhershme në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.

II. Dispeçer/e (Menaxher/e i/e Kontrollit), një (1)

Departamenti i Operimeve, Divizioni i Kontrollit, nr. ref. 05/3

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbikëqyrja dhe puna me personelin i cili punon në teren;
- Evidentimi i punës jo të rregullt në teren, evidentimi i punës jo të rregullt të sistemit dhe mënjanimi i gabimeve;
- Mirëmbajtja e kompjuterëve portativ (verifikimi i korrektesisë së punës të kompjuterëve portativ dhe pajisjeve tjera);
- Përgatitja e kompjuterëve portativ dhe pajisjeve përcjellëse për punë në terren (mbushja e baterive, rregullimi i parametrevave të pajisjeve dhe printerëve);
- Dhënie e pajisjeve për punën e kontrollorëve (kompjuterin portativ PocketPC dhe printerin portativ) në fillim të ndërrimit dhe pranimin në fund të ndërrimit.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi universitar;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Preferohet të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar, në të folur dhe shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office);
- Preferohet të ketë patentë shofer, kategoria B.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe certifikatën mbi të kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

Kontratë pune për periudhë të caktuar: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë të përhershme në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.

III. Zyrtar i ri për Zhvillim të Biznesit, dy (2)

Departamenti për Zhvillim të Biznesit, Divizioni për Planifikim dhe Zgjerim, nr. ref. 05/1

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për punën në lëshimin e marrëveshjeve (kontratave), bën verifikimin e dokumentacioni të nevojshëm për vendeparkimet;
- Mban evidenca për çdo marrëveshje (kontratë) për vendeparkimi;
- Është përgjegjës për menaxhimin e vendeparkimeve individuale;
- Është përgjegjës për zbatimin e rregullave dhe urdhërave të Kryeshefit Ekzekutiv;
- Kryeshefi Ekzekutiv mund ta ngarkojë me detyra tjera sipas rasteve emergjente të ndërmarrjes;
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, si dhe detyrave të ngarkuara nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi universitar;
- Preferohet të ketë përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Preferohet të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar, në të folur dhe shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office);
- Preferohet të ketë patentë shofer, kategoria B.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe certifikatën mbi të kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

Kontratë pune për periudhë të caktuar: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë të përhershme në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.

IV. Zyrtar i ri për Arkivë, një (1)

Departamenti i Administratës, Divizioni i Logjistikës dhe Arkivës, nr. ref. 04/5

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon dhe siguron sistemimin dhe mbajtjen azhure të lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit;
- Analizon dhe përcakton në përputhje me ligjin mënyrën e mbajtjes së regjistrit arkivor dhe lëndëve arkivore;
- Siguron që njësitë arkivore të jenë të shënuara me shenjat e përcaktuara sipas rregullave;
- Përkujdeset për afatet e arkivimit të lëndëve, si dhe përgatit lëndët me afat të përhershëm për dorëzim në Arkivin e Republikës të Kosovës sipas dispozitave ligjore;
- Regjistrohet të dhënat nga format standarde në bazën kompjuterike të dhënave dhe kontrollon çdo ndryshim të propozuar për klasifikimin dytësor;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi universitar;
- Preferohet të ketë përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Preferohet të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar, në të folur dhe shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office);

Procedura e Konkurrimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe certifikatën mbi të kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

Kontratë pune për periudhë të caktuar: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë të përhershme në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në adresën e Ndërmarrjes Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A., rr. "Luan Haradinaj", p.n., Pallati i Rinisë (ish ASK), 10000, Prishtinë, Kosovë. Aplikacioni merret në selinë e NPL "Prishtina Parking" SH.A., si dhe në ueb faqen www.prishtinaparking.net. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara refuzohen ndërsa dokumentet që dorëzohen pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të pranohen. **Konkursi është i hapur nga data: 13 Janar 2023 deri më 27 Janar 2023, ora 16:00.**

PRISHTINA

**Ndërmarrja Publike Lokale
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë**

Na temelju odredaba članka 8. Zakona br. 03/L-212 Radnih i Administrativnih Uputa (MPMS) br. 07/2017 za regulisanje tenderskih postupaka u javnom sektoru, lokalno javno poduzeće "Prishtina Parking" SH.A. najavi ovo:

UGOVORENI**Za pozicije:****I. Kontrolor, petnaest (15)**

Operativni odjel, Sektor za kontrolu, br. ref.: 05/3

Dužnosti i odgovornosti:

- Provjera ispravnosti parkiranja na uličnim parkiralištima i izdavanje ugovornih kazni;
- Dispečer preuzima prijenosno računalo na početku smjene i obavještava ga da radi na njemu;
- Posjete određenim mjestima;
- Prijava vozila, odnosno korisnika parkirališta koji su prekršili odredbe pravilnika društva o organizaciji i načinu naplate parkiranja;
- Bilježi podatke o vozilu i mjesto prekršaja na prijenosno računalo;
- Izdaje nalog za plaćanje ugovorne kazne korisniku parkirališta koji je prekršio propise društva;
- Nakon završene smjene vraća prijenosno računalo dispečeru

O sposobljenost i stručna sprema :

- Sveučilišno obrazovan je ;
- Poželjno je radno iskustvo;
- Imati dobre komunikativne vještine i pregovaračke vještine;
- Poželjno je osnovno poznavanje rada na računaru;
- Poželjno je posjedovanje vozačke dozvole B kategorije.

Procedura natjecanja

Kandidat za ovu poziciju dužan je dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Aplikaciju;
- Dokaz o stručnoj spremi (ovjerena kopija);
- Dokaz o radnom iskustvu (Pension Trust);
- Uvjerenje da nije pod istragom (ne starije od šest (6) mjeseci) i u vjerenje o kriminalnoj prošlosti;
- Porezno uvjerenje od PAK -a;
- Ekstrakt rođenja;
- Presliku osobne iskaznice.

Ugovor o radu na određeno vrijeme: šest (6) mjeseci probnog rada, uz mogućnost na stavljanje na neodređeno vrijeme u slučaju pozitivne ocjene radnog učinka.

II. Dispečer (voditelj kontrole), jedan (1)

Operativni odjel, Sektor za kontrolu, br. ref. 05/3

Dužnosti i odgovornosti:

- Nadzor i rad s osobljem koje radi na terenu;
- Evidencija nepravilnog rada na terenu, utvrđivanje nepravilnog rada sustava i otklanjanje grešaka;
- Održavanje i prijenos računala (provjera ispravnosti rada prijenosnih računala i drugih uređaja);
- Priprema prijenosnih računala i opreme za praćenje za rad na terenu (punjenje baterija, podešavanje optičkih parametara pinterera);
- Izdavanje uređaja za rad na kontrolu (Poc ketPC prijenosno računalo i prijenosni printer) na početku smjene i preuzimanje na kraju smjene.

O sposobljenost i stručna sprema

- Sveučilišno obrazovan je;
- Najmanje dvije (2) godine radnog iskustva;
- Imati dobre komunikativne vještine i pregovaračke vještine;
- Poželjno je dobro poznavanje stranih jezika u pisanju, govoru i radu na računaru (Microsoft Office);
- Poželjno je posjedovanje vozačke dozvole B kategorije.

Procedura natjecanja

Kandidat za ovu poziciju dužan je dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Aplikaciju;
- CV;
- Dokaz o stručnoj spremi (ovjerena kopija);
- Dokaz o radnom iskustvu (Pension Trust);
- Uvjerenje da nije pod istragom (ne starije od šest (6) mjeseci) i u vjerenje o kriminalnoj prošlosti;
- Porezno uvjerenje od PAK -a;
- Ekstrakt rođenja;
- Presliku osobne iskaznice;
- Motivacijsko pismo.

Ugovor o radu na određeno vrijeme: šest (6) mjeseci probnog rada, uz mogućnost na stavljanje na neodređeno vrijeme u slučaju pozitivne ocjene radnog učinka.

III. Novi službenik za poslovni razvoj, dva (2)

Odjel za razvoj poslovanja, Sektor za planiranje i širenje, br. ref. 05/1

Dužnosti i odgovornosti:

- Odgovoran je za rad u izdavanju spora zuma (ugovora), ovjerava potrebnu dokumentaciju za parkirna mjesta;
- Vodi evidenciju o svakom dogovoru (ugovoru) o parkirnim mjestima;
- Odgovoran je za upravljanje pojedinačnim parkirnim mjestima;
- Odgovoran je za provedbu pravila i uredbi Glavnog izvršnog direktora;
- Glavni izvršni direktor može ga povjeriti drugim dužnostima prema hitnim slučajevima poduzeća;
- U slučaju odsutosti drugih službenika, po nalogu glavnog izvršnog direktora, može ih zamijeniti i obavljati druge poslove;
- Obavlja druge poslove u vezi s općim radnim zadacima, kao i poslove koje mu povjeri glavni izvršni direktor.

O sposobljenost i stručna sprema

- Sveučilišno obrazovan je;
- Poželjno je radno iskustvo;
- Imati dobre komunikativne vještine i pregovaračke vještine;
- Poželjno je dobro poznavanje stranih jezika u pisanju, govoru i radu na računaru (Microsoft Office);
- Poželjno je posjedovanje vozačke dozvole B kategorije.

Procedura natjecanja

Kandidat za ovu poziciju dužan je dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Aplikaciju;
- CV;
- Dokaz o stručnoj spremi (ovjerena kopija);
- Dokaz o radnom iskustvu (Pension Trust);
- Uvjerenje da nije pod istragom (ne starije od šest (6) mjeseci) i u vjerenje o kriminalnoj prošlosti;
- Porezno uvjerenje od PAK -a;
- Ekstrakt rođenja;
- Presliku osobne iskaznice;
- Motivacijsko pismo.

Ugovor o radu na određeno vrijeme: šest (6) mjeseci probnog rada, uz mogućnost nastavka na neodređeno vrijeme u slučaju pozitivne ocjene radnog učinka.

IV. Novi službenik arhiva, jedan (1)

Odjel za upravu, Odsjek za logistiku i arhivu, br. ref. 04/7

Dužnosti i odgovornosti

- Pomaže i osigurava sistematizaciju i ažurnu pohranu arhivskog gradiva te predlaže smjernice potrebne za rad arhiva;
- Analizira i uskladuje sa zakonom utvrđujući način vođenja arhivskog registra i arhivskih predmeta;
- Brine se da arhivske jedinice budu označene znakovima od ređenih pravilima;
- Brine se o rokovima arhiviranja predmeta, kao i priprema predmete sa stalnim rokom za predaju Arhivu Republike Kosovo prema zakonskim odredbama;
- Evidencija podataka iz standardnih obrazaca u računalnu bazu podataka i provjerava predložene izmjene sekundarne klasifikacije;
- Obavlja druge dužnosti u skladu sa zakonima i propisima koje nadređeni razumno može zahtijevati s vremena na vrijeme.

O sposobljenost i stručna sprema

- Sveučilišno obrazovan je;
- Poželjno je radno iskustvo;
- Imati dobre komunikativne vještine i pregovaračke vještine;
- Poželjno je dobro poznavanje stranih jezika u pisanju, govoru i radu na računaru (Microsoft Office).

Procedura natjecanja

Kandidat za ovu poziciju dužan je dostaviti sljedeću dokumentaciju:

- Aplikaciju;
- Dokaz o stručnoj spremi (ovjerena kopija);
- Dokaz o radnom iskustvu (Pension Trust);
- Uvjerenje da nije pod istragom (ne starije od šest (6) mjeseci) i u vjerenje o kriminalnoj prošlosti;
- Porezno uvjerenje od PAK -a;
- Ekstrakt rođenja;
- Presliku osobne iskaznice;
- Motivacijsko pismo.

Ugovor o radu na određeno vrijeme: šest (6) mjeseci probnog rada, uz mogućnost na stavljanje na neodređeno vrijeme u slučaju pozitivne ocjene radnog učinka.

Pravo prijave imaju svi punoljetni državljani Republike Kosovo koji imaju punu poslovnu sposobnost, imaju završeno obrazovanje i stručnu sposobnost za obavljanje svojih dužnosti.

Ispunjeni dokumenti moraju se dostaviti na adresu lokalnog javnog poduzeća "Prishtina Parking" SH, ul. "Luan Haradina j", p.n., Palata mladosti (bivši ASK), 1000 0, Prishtina, Kosovo.

Zahtjev se prima u sjedištu NPL "Prishtina Parking" S.A., kao i na web stranici www.prishtinaparking.net. Kandidati koji se natječu dužni su unijeti točnu adresu, kontaktni telefon i e-mail adresu. Samo odabrani kandidati bit će pozvani na razgovor. **Nepotpuni dokumenti se odbijaju, dok se dokumenti dostavljeni na konnatječajnog roka neće prihvatiti.** Na natječaj je otvoren od: 13. siječnja 2023. do 27. siječnja 2023. do 16:00 sati.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULË

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pulë



cilësi e garantuar

pa konservues